


FONDACIONI SHOQËRI E HAPUR –  
MAQEDONI

**RAPORTI  
VJETOR  
| 2016 |**



Shkurt 2017

## || PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA DERI NË FUND TË VITIT 2016 ||

*Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni (FShHM)*, në kuadër të strategjisë së saj për periudhën 2014-2017 i drejton resurset dhe përpjekjet përkatëse për kthim të demokracisë dhe sundimit demokratik, si një qëllim afatgjatë, me anë të:

- Mbështetje të organizatave qytetare për përparim të fushave vijuese që janë identifikuar si më të rrezikuara: 1) liria e shprehjes; 2) përparimi i të drejtave të njeriut në shëndetësi; 3) angazhimi i të rinjve për ndryshime shoqërore; 4) lufta kundër korrupsionit; 5) monitorimi dhe dokumentimi i të drejtave të njeriut dhe 6) transparenca buxhetore. Këto organizata kanë ekspertizë relevante, qasje në grupe të caktuara të synimit, koalicione mirë të ndërtuar dhe baza të alumni, që ju mundëson në mënyrë efikase të artikulojnë strategjitë e tyre dhe të përgjigjen sfidave dhe rrethanave të mundshme.
- Zbatimi i katër koncepteve: 1) Përforcimi dhe mobilizimi i qytetarëve; 2) Komunë sipas nevojave të qytetarëve; 3) Integrim të Romëve; dhe 4) Ndihmë humanitare dhe ligjore për migrantët.
- Zbatimi i iniciativës për krijim të kornizës së përbashkët për përforcim ligjor dhe institucionalizimi i saj me anë të rritjes së formave të ndryshme aktuale të sigurimit të qasjes në drejtësi që bazohen në komunitet për nevojat e Romëve, punëtorëve seksual, përdoruesit e drogave dhe grupeve tjera të marginalizuar, në nivel lokal dhe kombëtar.

Shuma e plotë e mjeteve të shpenzuar për zbatim të aktiviteteve të FShHM në vitin 2016 është 274.761.367 denarë prej të cilëve 226.167.235 denarë rrjedhin nga Fondacionet Shoqëri e Hapur, ndërsa 48.594.131 denarë janë nga donatorë tjerë.

**PËRMBAJTJA**

<b>Përmbledhje .....</b>	<b>1</b>
<b>Përmbajtja .....</b>	<b>2</b>
<b>Mbështetje të fushave strategjike .....</b>	<b>3</b>
<b>Koncepte në vitin 2016 .....</b>	<b>10</b>
<b>Korniza e përbashkët për përforcim ligjor .....</b>	<b>23</b>

## || MBËSHËTETJE TË FUSHAVE STRATEGJIKE ||

### **Arritje dhe/ose aktivitete kryesore që kanë shënuar punën e organizatave të mbështetura në fushat strategjike të FShHM në vitin 2016**

#LIRIA E SHPREHJES

#### **• QENDRA PËR ZHVILLIMIN E MEDIEVE •**

*Qendra për Zhvillimin e Medieve (QZhM)* ka filluar vitin 2016 me publikimin në kohën e njëjtë të tre dokumenteve për politika publike: “Mediet dhe Ligjvënia Zgjedhore;”, “Mediet informative në internet dhe Ligjvënia Mediatike në Maqedoni” dhe “Fushata për informim publik të Qeverisë dhe institucioneve qeveritare (reklamimi qeveritar)”. *QZhM* ishte në mënyrë aktive e kyçur në përpjekjet për krijim të koalicionit joformal të organizatave që punojnë në sektorin mediatik për të përcaktuar drejtime të mundshme për prioritetet urgjente reformuese demokratike në Republikën e Maqedonisë, që ka rezultuar me përgatitjen e dokumentit “Propozim për Reforma Urgjente Demokratike”. Si organizatë që siguron ndihmë juridike falas dhe përfaqësim për mediet dhe gazetarët në procedura qytetare dhe penale të nisura kundër atyre në lidhje me njoftimin e tyre, *QZhM*-ja ka siguruar këshilla për mbrojtjen e 26 gazetarëve dhe medieve.

#### **• METAMORFOZIS – FONACIONI PËR INTERNET DHE SHOQËRI •**

Gjatë vitit 2016, *Metamorfozis – Fondacioni për Internet dhe Shoqëri (Metamorfozis)* me anë të përdorimit të veglave të internetit si agregatorin e lajmeve *Ping.mk*, portalin informativ *Portabl.mk* (në gjuhën shqipe), si dhe në sinergji me agjencinë e lajmeve *Mema.mk* (në gjuhën maqedonishte dhe anglishte) dhe me prani të madhe në mediet sociale, ka rritur dukshmërinë e iniciativave qytetare maqedonase në vend dhe jashtë vendit. *Metamorfozis* ka bashkëpunuar me *Global Vojs*, *EDRI (European Digital Rights)*, *APC (Association for Progressive Communications)* dhe *IFEKS* për të siguruar përhapje të informacioneve për Maqedoninë jashtë vendit për të nxitur përfaqësim të lirisë së shprehjes në Parlamentin Evropian dhe njoftuesin special të OKB për të drejtat e njeriut. *Metamorfozis* ka vazhduar bashkëpunimin me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Drejtave Personale me anë të aktivitetit promovues “Lënda e privatësisë”, që ka përfshirë përhapje të njohurive për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe privatësinë, lirinë e shprehjes dhe luftën kundër të folurit e urrejtjes në gjithsej 21 shkolla të mesme në Shkup, Prilep, Gostivar, Kërçovë, Strugë dhe Tetovë. Përveç kësaj, *Metamorfozis* ka vazhduar të ndërtojë kapacitetet e organizatave qytetare në Maqedoni për përdorimin strategjik të teknologjive të reja në avancimin e misioneve të tyre me anë të trajnimeve dhe donacioneve në softuerë.

Në dhjetor të vitit 2016, me mbështetje nga programi tematik për informacione në Nju Jork, *Metamorfozis* ka vazhduar zbatimin e projektit “Iniciativa për resurse të hapura arsimore në Maqedoni” që ka për qëllim të krijojë ekosistem të hapur

arsimor në Maqedoni në të cilën do të mundësohet shpërndarja e lirë e njohurive në internet.

#### • **MEDIE ON-LINE** •

Katër mediet on-line informative (*A1on.mk; Plusinfo.mk, Portalb.mk dhe Okno.mk*), ju kanë mundësuar qytetarëve informacione për tema aktuale dhe ngjarje në vend dhe jashtë vendit. Përveç njoftimeve për ngjarjet në Maqedoni, këto medie on-line në kohën e njëjtë kanë ofruar informim profesional qytetareve për tema nga jashtë, dhe që kanë të bëjnë me gjendjet në Maqedoni por edhe për situatat aktuale në rajon dhe më gjerë. Për shkallën e leximit dhe rejtingun e tyre në mesin e qytetarëve, flasin të dhënat e fituara nga *YouTube, Google, Analytics, GRID.MK* në të cilën vërehet rritje e numrit të lexuesve.

#### #**AVANCIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHËNDETËSI**

#### • **KOALICIONI I TË DREJTAVE SEKSUALE DHE SHËNDETËSORE TË KOMUNITETEVE TË MARGJINALIZUARA** •

Në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut të komuniteteve të marginalizuara, *Koalicioni Të drejta Seksuale dhe të Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara (Koalicioni DSShKM)* ka vendosur bashkëpunim me më shumë institucione shtetërore, me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të nëpunësve shtetëror për punë me anëtarët e këtyre komuniteteve. Ashtu, në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale është zhvilluar trajnim për 50 punëtorë social të Qendrave Ndërkomunale për Punë Sociale prej 25 qyteteve, ndërsa 20 anëtarë të komisioneve lokale për të drejtat e pacientëve nga Delçeva, Shkupi, Ohri, Shtipi, Manastiri dhe Strumica ishin trajnuar për zbulimin e diskriminimit mbi LGBTI komunitetin, si dhe për mundësitë e avancimit të të drejtave shëndetësore dhe mbrojtje të komuniteteve të marginalizuara. Me qëllim të hartimit të gjendjes së shërbimeve aktuale mjekësore për trans-personat ishte përpiluar një analizë që do të ndahet me trans komunitetin dhe punëtorët shëndetësor, por edhe vendimmarrës së vendimeve për shkak të ndryshimeve të gjendjes aktuale.

Për të promovuar të drejtat e LGBTI komunitetit ishin zhvilluar nëntë ngjarje publike dhe fushatë kundër homofobisë dhe dhunës trans-fobike në Kumanovë, Tetovë dhe Manastir. *Koalicioni DSShKM* ka organizuar festival treditör të filmit me filma alternativë dhe video me tema të lidhura me seksualitetin, gjininë, dhe trupin në artin e filmit në ish Jugosllavi. Në kuadër të monitorimit të rregullt dhe dokumentimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të komuniteteve të marginalizuara, ishte monitoruar zbatimi i Strategjisë për Avancimin e Shëndetit Seksual dhe Reproductiv që tregon se nuk janë parashikuar mjete buxhetore për zbatimin dhe nuk zbatohet në mënyrë përkatëse.

Si rezultat i monitorimit të lajmërimit mediatic lidhur me LGBTI, janë parashtruar gjashtë ankesa në Komisionin për Ankesa pranë Këshillit për Etikë në Medie të RM-së për shkak të fjalës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual, identitetit gjinor, si dhe për shkak të mosrespektimit të privatësisë së LGBTI personave dhe punëtorëve

seksual. Përveç kësaj, në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi është dorëzuar parashtresë për të folurit e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe përcaktimit politik.

Në partneritet me *HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup* dhe *Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Politika për Droga pranë Universitetit të Eseks*, është dorëzuar raport në hije në Komitetin për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore pranë Kombeve të Bashkuara. Para komitetit të njëjtë është dorëzuar raport për gjendjen me të drejtat riprodiktive të grave nga ana e *H.E.R.A. - Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim* dhe *Koalicioni DSShKM*. Në bazë të zbulimeve, janë përgatitur propozim-rekomandime për avancimin e të drejtave riprodiktive të grave në RM dhe në partneritet me ILGA<sup>1</sup>, është përgatitur një parashtresë e përbashkët për gjendjen me të drejtat shëndetësore të personave trans-gjini për në Komitetin Evropian për të Drejta Sociale.

#### • HOPS – OPSIONE PËR JETË TË SHËNDOSHË SHKUP •

Gjatë vitit 2016, në kuadër të Programit për Sigurim të Ndhmës Para-Ligjore dhe Sociale të Punëtorëve Seksual të *HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup (HOPS)*, janë organizuar punëtori në temat vijuese: zbulimi i rasteve të dhunës; përmirësimi i shkathtësive të komunikimit; përfitimi i informacioneve dhe edukimit lidhur me shëndetin seksual dhe riprodiktiv; diskriminimi dhe mekanizma të mbrojtjes; dhuna familjare; mbrojtja shëndetësore dhe realizimi i të drejtave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale. Para-ligjorët e angazhuar kanë realizuar gjithsej 573 vizita në teren të 178 punëtorëve/punëtoreve seksual në Shkup, Strumicë, Strugë, Ohër dhe Gostivar gjatë së cilës kanë ofruar ndihmë para-ligjore për raste të identifikimit të shkeljes së të drejtave në fushën e mbrojtjes sociale, sigurimit shëndetësor, diskimin për shkak të punës seksuale dhe trans-gjini.

Në kuadër të Programit për Zvogëlimin e Dëmeve tek të Rinjtë të *HOPS* ishin siguruar 720 shërbime për gjithsej 33 fëmijë, gjatë së cilës ishin dhënë informacione dhe këshillime lidhur me kursimin e varshmërive, përftimit të sigurimit shëndetësor dhe marrjes së dokumenteve personale, zvogëlimit të rreziqeve nga HIV dhe hepatit C. Përveç kësaj, ekipi i *HOPS* ka punuar në motivimin e prindërve, fëmijët e cilëve përdorin drogë, të fillojnë me kurimin me anë të institucioneve shëndetësore, gjegjësisht, Klinikës së Psikiatrisë, Departamentit për Fëmijë dhe të Rinj, Entit për Shëndet Mental të Fëmijëve dhe të Rinjve dhe Klinikës së Toksikologjisë.

Në vitin 2016, ekipi ligjor i *HOPS* ka përgatitur analizë krahasuese të kornizës ligjore të punës seksuale në Suedi, Zelandë të Re dhe Gjermani si modele të mira, gjatë së cilës është bërë pasqyrë e efekteve pozitive dhe negative mbi jetën, shëndetin dhe punën e punëtorëve seksual. Përveç kësaj, pas analizës së zbatuar të qëndrimeve të 310 punëtorëve seksual për nevojën e ndryshimeve të rregullores

<sup>1</sup> *International Lesbian and Gay Association*

ligjore për punën seksuale, ishin përgatitur propozim-zgjidhje të për ndryshime dhe plotësim të kornizës aktuale ligjore në RM për rregullimin e punës seksuale.

### #ANGAZHIMI RINOR PËR NDRYSHIME SHOQËRORE

#### • FORUMI RINOR ARSIMOR •

Projekti “Angazhimi Rinor për Ndryshime Shoqërore” ishte zbatuar në 20 klube rinore që krijojnë hapësirë për mësim, aktivizëm dhe integrim të rinjve në 10 qytete nëpër Maqedoni. Më tepër se 500 persona të rinj kanë punuar dhe mësuar në klubet *Debate*, *Mësojmë të Drejtën dhe MediArt* dhe kanë shkruar njohurinë e përfituar në iniciativa të drejtpërdrejta lokale me anë të shfaqjeve, ekspozitave të fotografive, libra me vizatime, kuisë dhe ngjarje tjera kreative. Anëtarët e klubeve *Mësojmë të Drejtën* janë njoftuar me institucionet dhe kanë vizituar – Zyrën e Avokatit të Popullit në Shkup, Tetovë dhe Manastir dhe gjykatat themelore në Tetovë dhe Kumanovë. Katërqind qytetarë kanë vizituar ekspozitat e fotografive të anëtarëve të klubeve për problemet në Strugë, Tetovë, Veles dhe Negotinë. Të rinjtë nga Tetova kanë mbuluar shkresat me të folurit e urrejtjes, ndërsa në Veles kanë vizituar art televizor dhe kanë organizuar projektme në rrugë, ndërsa të Negotinës kanë publikuar libër me vizatime për të rinj me veprat e tyre – Strip Art.

Njëqind nxënës të shkollave të mesme kanë hulumtuar dhe kanë debatuar në kuadër të Kampionatit Kombëtar për Debate që janë zhvilluar më 7 dhe 8 maj 2016 në Universitetin FON. Në vitin 2016 *Forumi Rinor Arsimor (FRA)* ka mbështetur katër komunitete të nxënësve të shkollave të mesme në shkollat “Koço Racin” – Veles, “Kiril Pejçinoviç” – Tetovë, “Shën Kirili dhe Metodi” – Negotinë dhe “Jane Sandanski” – Manastir dhe kanë përforcuar kapacitetet e tyre për zbatimin e hulumtimeve, dhe ka siguruar ndihmë për tre këshilla lokal për të rinj në komunat Çair, Strugë dhe Dibër për të përmirësuar punën dhe llogaridhënien e tyre.

Një prej arritjeve kryesore të organizatës janë pakoja e rekomandimeve për të rinj, reformat në arsim dhe politika tjera të ngjashme që ishin përfshirë në Rezolutën e Parlamentit Evropian për Republikën e Maqedonisë të miratuar në vitin 2016. Gjithashtu, *FRA* në mënyrë aktive ka marrë pjesë në proceset e krijimit të politikave publike, siç janë përpunimi i Strategjisë Gjithëpërfshirëse për Arsimin në RM dhe dokumenti i shoqërisë qytetare “Propozim për Reforma Urgjente Reformuese”.

Në vitin 2016, *Radio MOF* rinore kanë pasur më tepër se 1.000.000 vizita, ndërsa artikujt kryesore kanë përfshirë lajme hulumtuese për ndotjen, arsimin dhe organizatat qytetare. Kjo medie ka mbuluar edhe lajme të jetës së të rinjve, transportin publik dhe migracionin dhe çështje tjera të hidhura në interes të të rinjve.

#### • FONDACIONI PËR DEBAT DHE EDUKIM IDEJA EVROPË JUGLINDORE •

Arti i përfaqësimit është projekt rajonal i *Fondacionit për Debat dhe Edukim Ideja Evropë Juglindore*, ku aktivistët e rinj për të drejtat e njeriut, si dhe përfaqësues të organizatave qytetare rinore përfitojnë shkathtësi të reja për përfaqësim me anë të

shprehjeve artistike. Nga 22 deri 29 qershor 2016, në Ohër, 60 pjesëmarrës nga 10 vende të rajonit të Evropës Juglindore kanë mësuar si të përfaqësojnë idetë e tyre me anë të librave me vizatime, data vizualizim, muzikë dhe poezi si vegla të përfaqësimit. Projekti është financiar nga programit tematik Iniciativa për të Drejta të Njeriut nga Nju Jorku.

### #LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

#### • QENDRA MAQEDONASE PËR ARSIMIN EVROPIAN •

Gjatë gjithë vitit, *Qendra Maqedonase për Arsimin Evropian (QMAE)* ka përgatitur një analizë krahasuese të raporteve të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë dhe ka prezantuar si pjesë e konferencës vjetore “Gabime urgjente reformuese” që u zhvillua në nëntor 2016, dhe në të cilën anë debatuar çështje kryesore me përfaqësues tjerë të shoqërisë qytetare dhe komunitetit ndërkombëtar. U dëshmuua që analiza krahasuese edhe më tutje është me rëndësi të madhe dhe paraqet një bosht për debat të përgjithshëm të organizuar në lidhje me aderimin e vendit në BE sepse paraqet një pasqyrë ideale e vërejtjeve të Komisionit, dhe tregon edhe zhvillimin e sektorit dhe trendët pozitive dhe negative të reformave dhe mungesa e tyre.

Vitin e tretë me radhë, *QMAE* ka zbatuar hulumtimin anketues EVROMETËR për pranimin e vlerave evropiane, mbështetjen për aderimin në BE dhe atmosferë në frikës në vend. Të dhënat e mbledhura ishin përdorur për përgatitjen e brifingjeve dhe raporteve, por edhe për përgatitjen e dokumenteve për politika publike që kanë adresuar ngecjen në procesin e aderimit në BE. Përveç kësaj, *QMAE* ka organizuar Shkollën për Politika Evropiane të dedikuar demokracisë me anë të diskutimeve mbi temat siç janë aderimi në BE, evopizimi, populizmi dhe regjime jo-liberale në Evropë. Në shkollën që u organizua në fillim të tetorit 2016 kanë marrë pjesë më tepër përfaqësues të shoqërisë qytetare, aktivistë, por edhe punëtorë shkencorë nga universitete dhe qendra hulumtuese nga Maqedonia dhe rajoni (Serbi, Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë). Ishin organizuar gjashtë seanca edukative-debatuese EURO-TALK për think-tank komunitetin në Shkup dhe për përfaqësues të më tepër organizata relevante qytetare në tema lidhur me evopizimin e shoqërisë, BE-në si faktor global, politika të zgjerimit dhe aderimin e Republikës së Maqedonisë në BE.

### #MONITORIMI DHE DOKUMENTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

#### • KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTA TË NJERIUT TË RM •

Gjatë vitit 2016, *Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i RM-së (Komiteti i Helsinkit)* ka siguruar ndihmë juridike falas në gjithsej 371 raste edhe atë në procedurë ekzekutive 2 raste, në procedurë administrative, 22 raste, në procedurë qytetare, 14 raste, në procedurë penale, 62 raste, në procedurë shkeljeje, 8 raste, në konteste pune, 19 raste, në fushën e burgjeve dhe spitaleve psikiatrike, 17 raste, në fushën e të drejtave të njeriut dhe policisë, 15 raste, në fushën e të drejtave shëndetësore dhe sociale, 24 raste, në fushën e të drejtës familjare, 12



raste, në fushën e kontesteve të punës, 19 raste dhe për kushte të paraburgimit, 7 raste.

Në këtë periudhë ishte përgatitur raport në hije për në Komitetin për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në sajë të shqyrtimit të raportit periodik të dytë, tretë dhe të katërt të Republikës së Maqedonisë në lidhje me Paktin Ndërkombëtar të OKB-së për të drejta ekonomike, social edhe kulturore. Në këtë raport ishin adresuar problemet lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të migrantëve dhe personave që kanë kërkuar azil, largim të pazakontë të së drejtës për ndihmë sociale në të holla të personave të rrezikuar social dhe në qasjen e shërbimeve sociale për LGBTI personave, mos zbatimit të Ligjit për Parandalim, Ndalim dhe Mbrojtje nga Dhuna Familjare nga e institucioneve relevante, sistemi joefikas shëndetësor dhe qasje e penguar në shërbime shëndetësore, segregimi i fëmijëve Rom në institucionet e arsimit publik dhe qasja në arsim në burgjet adoleshente.

Gjatë vitit 2016, *Komiteti i Helsinkit* ka përforcuar bashkëpunimin me shoqatat qytetare vendore dhe ndërkombëtare. Anëtarët e Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi kanë përgatitur komente dhe rekomandime për propozim Strategjinë Kombëtare për Mos-Diskriminim 2016-2020 që kanë dorëzuar në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Rekomandimet që kanë të bëjnë me komunitetet e marginalizuar si LGBTI personat, përdoruesit e drogave, punëtorët seksual, ishin pranuar nga ministria. Përveç kësaj, përfaqësues të Rrjetit për Mbrojtje nga Mos-Diskriminimi në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në grupin e punës për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Mos-Diskriminimi.

#### #TRANSPARENCA BUXHETORE

#### • SHOQATA PËR EMANCIPIM, SOLIDARITET DHE BARAZI TË GRAVE – ESB •

Për të përcaktuar ndikimet e politikave tjera që janë jashtë fushës së shëndetësisë, dhe kanë ndikim mbi buxhetin shëndetësor, *Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESB (ESB)* ka filluar një proces të hartimit dhe analizës së politikave dhe rregulloreve kryesore kombëtare makro-ekonomike (faza e parë) dhe vendosja e indikatorëve kryesore që do të shërbejnë si bazë për analizë të vazhduar të ndikimeve makro-ekonomike dhe politikave mbi sektorin social dhe shëndetësor (faza e dytë). Në kuadër të monitorimit dhe analizës së buxheteve për mbrojtje shëndetësore dhe sociale nga perspektiva gjinore, është përgatitur analizë për punë të papaguar në amvisëritë rrome për kujdes të personave të sëmurë, dhe në lidhje me analizën e zbatimit buxhetor të Strategjisë Kombëtare për Luftë kundër Dhunës Familjare, në përgatitje është dokument që bashkon dy analiza për realizim të dy granteve<sup>2</sup> të ndarë të synuar për zbatimin e Strategjisë.

<sup>2</sup> UN Joint Program “Strengthening national Capacities to Prevent Domestic Violence 2008-2011”, dhe The UN Trust Fund in Support of Actions to Eliminate Violence against Women

Në bazë të dhënave nga dokumentet me qasje publike dhe këtyre të mbledhura në procedurë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, janë përgatitur raporte për zbatimin e Programit për Zbulim të hershëm të Sëmundjeve Malinje (kancer të grykës së mitrës) për periudhën 2012 deri 2014 dhe Programit për Kurimin e Sëmundjeve të Rralla për periudhën 2015-2016. Me qëllim të afrimit të zbulimeve para publikut më të gjerë, janë hartuar versione më të thjeshta të raporteve në formë të informacioneve me figura të prezantuar para medieve kombëtare dhe lokale, internet portalet dhe mediet e shtypura.

Në lidhje me avancimin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë dhe institucioneve, me rastin e 10 vjetorit të miratimit të Ligjit për Qasje të Lirë me Karakter Publik është dorëzuar informacion për gjithë mediet për nivelin e transparencës së institucioneve publike në RM, mënyrën e zbatimit të Ligjit dhe ndikimi i zbatimit të Ligjit mbi nivelin e transparencës së punës së institucioneve publike. Informacione për zbulimet nga notimi i nivelit të transparencës reaguese për vitin 2015 dhe mostër e raporteve të përgatitur ishin dorëzuar para 38 institucioneve.

Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e konceptit të ngjitur (llogaridhënie sociale dhe përforsimi ligjor) në bashkëpunim me Shkollën për Shëndet Publik pranë Universitetit Xhon Hopkins, është zbatuar një pilotim i pyetësorit për vlerësimin e gjerë të prioriteteve shëndetësore të Romëve. Për zbatim efikas të aktiviteteve në teren është përgatitur “Udhëzues për Animatorë dhe Lehtësues në Komunitetet Rome” dhe në tre organizata rome ishin trajnuar animatorë dhe lehtësues për punë në fushën e llogaridhënies sociale dhe përforsimit ligjor. Për informimin përkatës të animatorëve dhe lehtësuesve, ueb faqja [www.healthrings.mk](http://www.healthrings.mk) rregullisht ishte mirëmbajtur me gjithsej trembëdhjetë ndryshime dhe plotësime të rregulloreve ligjore, si dhe dhjetë publikime. Përveç kësaj, ESB ka siguruar mbështetje teknike për tre organizata partnere rome për zbatimin e revizionit social në lidhje me realizimin e vizitave patronazhe në amvisëritë rome dhe në lidhje me përfshirjen e grave rome në mbrojtje shëndetësore gjinekologjike sipas Programit për Zbulimin e Hershëm të Sëmundjeve Malinje.

**|| KONCEPTE NË VITIN 2016 ||**  
**Përparimi në lidhje me qëllimet kryesore në vitin 2016**

**|| PËRFORCIMI DHE MOBILIZIMI I QYTETARËVE**

Qëllimi i konceptit të përforcimit dhe mobilizimit të qytetarëve është kontribuojë për gjallërimin e sundimit demokratik.

Qëllimi i parë i konceptit është individët e përforcuar, grupe joformale dhe organizata qytetare, të koordinuar në platformë të hapur, përfshirëse dhe jo-partiake për të aktualizuar çështjet akute dhe provokuese si përgjigje të mbrapsjes së demokracisë.

Nga 107 aplikacione të arritura të konkursit në qershor 2016, *FShHM* ka dhënë grante për 11 projekte, në gjithsej shumë prej 100.740 dollarë për të kontribuar për përforcimin dhe mobilizimin e qytetarëve për përmirësim të praktikave demokratike në nivel lokal dhe kombëtar. Nga projektet e zgjedhura, 8 janë dhënë shoqatave, ndërsa 3 janë dhënë iniciativave joformale. Përveç kësaj, ishin mbështetur 13 aktivistë nga rrjetet sociale për të nxitur të menduarit kritik dhe debat në mediet e reja.

*FShHM* ka mbështetur aksionin qytetar *Ne vendosim!* që ka pasur për qëllim të informojë, motivojë dhe inkurajojë qytetarët të marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 11 dhjetor 2016. Aksioni qytetar është përqendruar edhe në monitorim të procesit zgjedhor dhe parregullsitë potenciale zgjedhore. Në kuadër të këtij aksioni ishin monitoruar financimi i fushatave zgjedhore dhe njoftimin në programin informativ TVM. Në pjesën e dytë të aksionit, fokusi qendror i aksionit qytetar ka qenë në promovimin dhe mbrojtjen e fshehtësisë së votës dhe linjën fals telefonike në të cilën janë paraqitur 140 qytetarë për të denoncuar parregullsi të mundshme zgjedhore. Veglat kryesore të aksionit qytetar ishin aktivitete në teren për informim të qytetarëve me anë të gazetës "*Ne vendosim!*" dhe flash-mob si dhe me anë të mesazheve audio-vizuale të gatshme në medie tradicionale dhe rrjete sociale. Në kuadër të aksionit gjithashtu ishte zbatuar dhe fushatë rinore "Voto për çfarë të duash" që ka pasur për qëllim të nxit daljen dhe jehonën në zgjedhjet e parakohshme.

Gjatë vitit 2016, në mediet e shtypura dhe sociale ishin publikuar dhe promovuar 9 ALARME prej të cilëve 6 ishin dedikuar propozim-buxhetit për vitin 2017, dhe 3 ishin dedikuar zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Gjatë vitit 2016 ishin zhvilluar 5 trajnime të ciklit "Shkolla për Kulturë dhe Politikë" në kohëzgjatje të plotë prej 20 ditë. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që përfaqësuesve të grupeve joformale dhe aktivistëve të sigurohen njohuri më të gjera mbi temat: kultura dhe politika, arti dhe fuqia, kultura e regjimit dhe kultura e rezistencës. Në trajnimin kanë marrë pjesë 134 pjesëmarrës nga qytete të ndryshme të Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 2016 kanë vazhduar aktivitetet për përkthim dhe shtypje të publikimeve/librave mbi tema të ndryshme shoqërore. Për publikim ishin përgatitur pesë librat më poshtë: “Drejt origjinës së nacionalizmit shqiptar” nga Natali Klejer, “Për të politikës” nga Shantal Muf, “Mendja populiste” e Ernesto Paklo, “Siguria, teoria, popullata” nga Mishel Fuko dhe “Nënkultura: Domethënia e stilit” nga Dik Hebdixh.

Klubi i Qytetarëve për Maqedoni Evropiane (GEM Klubi) ka vazhduar të jetë platforma e shprehjes së mendimit kritik publik dhe hapësirë e hapur i gatshëm për gjitha organizatat qytetare dhe grupe joformale. Janë zhvilluar gjithsej 204 ngjarje, të organizuar nga *FShHM* dhe shtatëdhjetë organizata, grupe joformale, iniciativa qytetare, ambasada, publikues, shoqëri teatrore në të cilat kanë marrë pjesë mbi 3.600 vizitorë.

Zbatimi i **Projektit të USAID për shoqëri qytetare**, që ka filluar në vitin 2012, dhe ka dashur të përfundojë në gusht 2016, ishte vazhduar deri në dhjetor 2016.

Gjatë vitit 2016, kanë vazhduar të zbatohet 41 grante të dhënë 39 organizatave qytetare në vitin paraprak. Grantet e dhënë janë prej tre komponentëve projektuese, edhe atë 14 grante për organizata qytetare që veprojnë si thelb demokratik në komunitetet e tyre, 13 grante për organizata qytetare që zbatojnë monitorim të pushteti dhe përfaqësim të bazuar në hulumtime dhe 14 grante për aksione të përbashkëta të organizatave qytetare.

Për përmirësim të kapaciteteve për zbatim të granteve të dhënë për projekte, *FShHM* ka realizuar 5 trajnime për: planifikim strategjik, shkathësi prezantimi dhe komunikimi, aktivizëm qytetar, komunikim me publikun dhe qasje të lirë në informacione me karakter publik. Për përfundim të kapaciteteve të organizatave qytetare për monitorim dhe përfaqësim, ishin organizuar 8 trajnime për: kuptim më të mirë dhe qasje në fonde evropiane, transparencë dhe llogaridhënie buxhetore, monitorim të transparencës buxhetore dhe llogaridhënie, përpilimi i dokumenteve efektive për politika publike, përfaqësim. Në trajnimet kanë marrë pjesë gjithsej 304 përfaqësues të organizatave qytetare dhe aktivistëve qytetar.

Në 3 takime për rrjetëzim në Shkup, në të cilën kanë marrë pjesë 57 përfaqësues të organizatave qytetare, grantistët kanë prezantuar aktivitetet dhe dinamikën e realizimit të projekteve.

*FShHM* në bashkëpunim me organizatën partnere *Reaktor – hulumtim në Aksion* ka organizuar 3 hakatone sociale për: përgatitje dhe zbatim të fushatave me fokus në internet-komunikimin, krijimi i përmbajtjeve për komunikim digjital dhe të dhëna të hapura dhe vizualizim të të dhënave në të cilën kanë marrë pjesë 61 përfaqësues të grantisëve. Në 4 punëtori, përfaqësuesit e organizatave qytetare dhe aktivistët qytetar kanë pasur mundësinë të krijojnë koncepte për aksione kreative qytetare, ngjarje dhe shfaqje.

Organizata partnere *Forumi Rinor Arsimor (FRA)* ka zbatuar Akademinë Verore Rinore të pjesë me 99 pjesëmarrës dhe 2 aksione të një pas njëshme në Veles dhe

Shkup, 3 aksione vullnetare me 70 pjesëmarrës (Delçevë, Strugë, Kratovë), iniciativa lokale në Manastir, Shkup, Resnjë dhe Tetovë, 2 fushata kombëtare rinore për promovim të argumentimit dhe debatit konkurrues për të drejtat qytetare dhe politike dhe liritë, ngjarjet *Stacioni Studentor 4.0* (me 25 organizata studentore dhe rinore dhe 300 vizitorë), *Argument: Të shprehurit e organizuar*, konferenca për aktivizëm social *Engage* dhe ngjarjet *Engage Youth* në Ponikva dhe *Engage@Akto* në Manastir (me mbi 1.000 vizitorë), turne rajonale debutuese në Negotinë, Tetovë dhe kërcove (me 77 pjesëmarrës-debatues). FRA ka promovuar videot për korrupsion në arsimin e lartë dhe librin e ri të programit *Mësojmë të drejtën* të FRA. Klubet e debatit në dy universitetet kanë organizuar takime, debate dhe diskutime për studentët.

Organizata partnere *Forum – Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentim* ka përfshirë 49 pjesëmarrës të gjeneratës së 9 dhe 10 të Shkollës për Qytetari Aktive, ka organizuar 3 punëtori refleksive për tre gjeneratat e fundit, takime me 47 alumnistë të Shkollës, dhe ka zbatuar 5 aksione të alumnistëve.

*Reaktor – Hulumtim në aksion* ka zbatuar hulumtimin për pjesëmarrjen qytetare për vitin 2016, ka përgatitur analizën krahasuese të hulumtimeve për pjesëmarrje qytetare nga viti 2012 deri 2016 dhe ka përditësuar ueb portalin dinamik [www.graganskoucestvo.mk](http://www.graganskoucestvo.mk) me të dhënat për vitin 2016.

Qëllimi i dytë i konceptit është përforcimi dhe mobilimi i qytetarëve për zhvillim të ligjeve alternative dhe politikave në mënyrë pjesëmarrëse, që do të demonstrojnë përfitimet nga përfshirja qytetare dhe do të mobilizojnë aktorët e shoqërisë qytetare të ndërmarrin aksione dhe rritje të veprimit për çështjet me interes publik.

Në sajë të këtij qëllimi, *FShHM* ka përgatitur 5 analiza që kanë për qëllim të japin kontribut për përmirësimi në praktikave të caktuara, kryesisht, lidhur me kapitullin 23 për aderim në BE, që përqendrohet në të drejtat e njeriut dhe ligjvënien. Temat e analizuar janë në vijim: përcaktimi i interesit publik në ligjvënien; zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut; efikasiteti i trupave të pavarur për të drejta të njeriut; puna e trupave rregullatore dhe ndikimi i mekanizmave për mbrojtje të të drejtave të njeriut të OKB në Republikën e Maqedonisë.

Në kuadër të Projektit të USAID për shoqëri qytetare, organizata partnere *Qendra për Komunikime Qytetare* ka publikuar 2 raporte periodike të monitorimit të prokurimeve publike të institucioneve në nivel kombëtar, 2 raporte në nivel lokal, 3 indekse të racionalizmit ka përgatitur publikimin përmbledhës të raporteve të monitorimit të prokurimeve publike të zbatuar gjatë 5 viteve të fundit në kuadër të projektit. Ishte publikuar edhe *Udhëzuesi për Qytetarët për Njohje dhe Monitorim të Prokurimeve Publike*. Qendra për Komunikime Qytetare ka krijuar dhe ka promovuar ueb faqen [www.opendata.mk](http://www.opendata.mk) që ka mundësuar pasqyrë të zbulimeve kryesore lidhur me monitorimin e prokurimeve publike dhe shpenzimin e të hollave publike.

Në bashkëpunim me *Qendrën Maqedonase për Arsim Evropian* ishin publikuar 6 raporte të monitorimit të aderimit në BE dhe analizë krahasuese të raporteve të Komisionit Evropian për Përparimin e RM-së për periudhën 2012-2016.

Projekti ka mundësuar publikim dhe përgatitje të 6 dokumenteve për politika publike lidhur me temat vijuese: investime të huaja të drejtpërdrejta, lista zgjedhore, të pastrehë, përparimi i punës së Gjykatës Kushtetuese dhe zhvillimi i barabartë rajonal. Në një sërë tryezash të rrumbullakët në Shkup, Tetovë, Strumicë, Manastir, Prilep dhe Dibër me palët e interesuara ishte diskutuar mbi rezultatet e projekteve të zbatuara dhe mundësitë e veprimit të mëtutjeshëm dhe përfaqësimit për rritje të ndikimit mbi aktivitetet projektuese.

Në sajë të aktiviteteve për përfaqësim, dhe në bashkëpunim me partnerë dhe grantisët e projektit, *FShHM* ka organizuar 10 ngjarje publike, edhe atë: debat dhe promovim të dokumentit “Propozim zgjedhje për përmirësim të politikës investuese në Republikën e Maqedonisë” (me *Shoqatën e Analistëve dhe Hulumtuesve të Rinj*), debati “Gabime Urgjente Reformuese” (me *Qendrën Maqedonase për Arsim Evropian*), debatet publike “Punëtorë kulturor dhe artistët e lirë: kushte dhe të drejta”, “Kultura në hetim – roli i artistit gjatë krizës sociale dhe politike” dhe “Çfarë të bëhet dhe si të arkivohet kultura për ndryshime qytetare?” (me *Fakultetin për punë që nuk mësohen*), diskutim “Çfarë humba për lirinë” (me organizatën studentore *Izlez*), 2 ngjarje debative: “Fundjavë e të drejtave të njeriut” dhe turneu kombëtar debativ për fillestarë (me *Forum Rinor Arsimor*), ngjarja përfundimtare e Shkollës për Qytetari Aktive (me *Forum – Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentim*), promovim të rezultateve nga hulumtimi dhe pjesëmarrja qytetare në Maqedoni nga vitit 2012-2016, “Si në angazhim më të rritur qytetar” (me *Reaktor – Hulumtim në Aksion*).

Në ngjarjen përfundimtare në dhjetor 2016, *USAID*, *FShHM* dhe organizatat partnere kanë prezantuar rezultatet e zbatimit të projektit pesëvjeçar të *USAID* për shoqëri qytetare.

Në gusht të vitit 2016, ka filluar Projekti për pjesëmarrje qytetare i zbatuar nga Ist Vest Instituti për Menaxhim (East West Management Institute – EWMI) në partneritet me katër organizata lokale qytetare edhe atë *Metamorfozis – Fondacioni për Internet dhe Shoqëri*, *Asociacioni i Iniciativave Demokratike*, *FShHM* dhe *Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë*. Projekti do të përforcojë pjesëmarrjen aktive të organizatave qytetare në lidhje me politikat dhe çështjet me interes publik, si dhe të rrit dhe mirëmbaje kyçjen e të rinjve në jetën publike në Maqedoni. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të organizatave që do të zbatojë *FShHM* do të fillojnë në janar 2017.

Në kuadër të zbatimit të **Programit Rajonal për Promovim të Hulumtimeve** (PRPH), ka vazhduar projekti “Dialogu Kombëtar për Përparimin e Politikave në Fushën e Shkencave Shoqërore në Maqedoni” në lidhje me rregullimin e hulumtimit në këtë fushë me qëllim të propozohet model për financim të veprimtarisë së hulumtimit shkencor me anë të së cilës do të avancohen cilësia,

efikasiteti dhe ndikimi i aktiviteteve hulamtuese, dhe njëherë do të përgjigjet nevojave të komunitetit hulamtues në Maqedoni.

Këtë projekt *FShHM* ka zbatuar në bashkëpunim me tre organizata hulamtuese: *Instituti për Politika Evropiane – Shkup*, *Shoqata Helthgruper Samit – Shkup*, dhe *Koalicioni Të drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar*, si dhe dy eksperte të pavarura – profesoret dr. Emilija Smioska dhe dr. Snezhana Biliq.

Projekti bazohet në analiza të fituara nga burime primare dhe sekondare, në bazë të së cilave janë përpiluar 3 studime për politika publike propozim model për financim të veprimtarisë hulamtuese shkencore<sup>3</sup>. Versioni i punës i modelit ishte prezantuar para publikut ekspert vendor dhe të huaj dhe palëve tjerë të interesuar në qershor 2016.

Rezultatet preliminare të hulamtimit empirik ishin prezantuar në 3 diskutime publike që janë zhvilluar në periudhën prej mars deri prill 2016. Diskutimi i parë ka përfshirë prioritetet tematike, gjegjësisht, nevojën e përqendrimit tematik të konkurseve publike për projekte hulamtuese shkencore. Në diskutimin e dytë theksi ishte vendosur në përparimin e procesit të aplikimit për grante hulamtuese shkencore nga ana e MASH, ndërsa diskutimi i tretë ka mbuluar temën e sigurimit të një procesi të cilësisë së lartë për vlerësim të propozim projekteve hulamtuese shkencore.

Përveç çështjeve të përfshirë në studimet për politika publike, ishin kërkuar përgjigje të 3 çështjeve plotësuese lidhur me përvojat krahasuese të rajonit dhe më gjerë, dhe gjithashtu, janë në interes për modelin. Nga kjo, dolën 3 qëndrime, gjegjësisht dokumente të shkurta për politika publike.

Në shkurt të vitit 2016, në Beograd ishte organizuar seminar rajonal “Menaxhimi cilësor i të dhënave dhe analiza” në të cilën kanë marrë pjesë 25 hulamtues të rinj. Në prill 2016, në Sarajevë, ishte organizuar akademia hulamtuese “Hyrje në Metoda Hulamtuese për Shkenca Shoqërore për Hulamtuesit e rinj të Ballkanit Perëndimor”. Në akademinë, në të cilën kanë ligjëruar 13 instruktorë nga universitete me renome dhe institute hulamtuese të Evropës Perëndimore dhe rajonit, kanë marrë pjesë 35 hulamtues të rinj.

Në shtator 2016, në Tiranë, ishte zhvilluar konferenca e fundit ndërkombëtare e PRPH në temën “A po ndryshohet Ballkani Perëndimor në kuptimin shoqëror, politik dhe ekonomik?” në të cilën kanë marrë pjesë më tepër se 100 hulamtues të rinj nga rajoni dhe më gjerë.

Në vitin 2016 me sukses ishin përmbyllur edhe 3 projektet tjera rajonale që ishin të mbështetur me thirrjen e vitit 2013.

Në mars të vitit 2016 në sajë të PRPH ishte publikuar një thirrje e brendshme për vazhdim të projekteve hulamtuese të vitit 2013. Të gjitha 6 organizatat

<sup>3</sup> [http://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/Predlog-model%20za%20finansiranje\\_MK.pdf](http://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/Predlog-model%20za%20finansiranje_MK.pdf)

maqedonase që kanë fituar grante plotësuese nga PRPH me sukses kanë realizuar projektet deri në fund të marsit 2017, me të cilën edhe zyrtarisht ka përfunduar ky program.

## || KOMUNA SIPAS NEVOJËS SË QYTETARËVE

Koncepti Komuna sipas Nevojës së Qytetarëve ishte realizuar në tre komunat më të mëdha, urbane dhe shumë etnike Strumicë, Qendër dhe Strugë në periudhën 2012-2016. Qëllimi i përgjithshëm ishte të ofrohet model i komunës sipas nevojës së qytetarëve në të cilën në mënyrë pjesëmarrëse ishin krijuar, dhe pastaj, edhe miratuar strategji lokale me plane veprimi për arsim, të rinj, mbrojtje sociale dhe për bashkëpunim me sektorin qytetar. Me anë të konceptit ishin siguruar lloje të ndryshme të trajnimeve për administratën komunale, të punësuarit në shkolla dhe për përfaqësues të sektorit qytetar, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të tyre dhe të përmirësohen shërbimet e qytetarëve. Në fillim të vitit 2016 ishin nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me kryetarët e këtyre komunave si vazhdim dhe përmbyllje të aktiviteteve të realizuara prej viteve 2014 dhe 2015.

Në kuadër të konceptit, në vitin 2016 ishin zbatuar trajnime: 1) për përforcimin e kapaciteteve të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së komunave për 36 të punësuar në administratë dhe për anëtarët e këshillave komunal, me fokus në buxhetimin lokal; si dhe 2) dhe për krijimin e komunës sipas nevojës së fëmijës, në të cilën kanë marrë pjesë 25 të punësuar në administratë dhe anëtarë të këshillave komunal. Qëllimi themelor i trajnimit të dytë ishte të drejtohen dhe mentorohen tre komunat për formim të një trupi/komisioni të veçantë që në plan të parë do të ketë interesin e fëmijës, si dhe përpilimin e vizionit dhe vlerave themelore si bazë për dokument strategjik për komunë sipas nevojës së fëmijës; ndërtimi i procedurave për pjesëmarrje të fëmijëve në fusha të ndryshme dhe aktivitete në nivelin lokal; si dhe nisja e buxhetit fëmijëror në kuadër të buxhetit komunal. Përfaqësues të organizatave qytetare në tre komunat kanë vizituar trajnim të avancuar për monitorim të prokurimeve publike për zgjerimin e njohurive dhe shkathtësive që kanë përfituar gjatë vitit 2015.

Për përfaqësuesit e shkollave ishte realizuar trajnim tre ditor për qasje kreative në mësimin që kanë vijuar 32 pjesëmarrës nga tre shkollat e projektit të komunave të Strumicës, Qendrës dhe Strugës. Gjithashtu, përfaqësues të organizatave qytetare ishin trajnuar edhe për metodologjinë e monitorimit të planeve të veprimit të strategjive lokale, me të cilën ky trajnim në mënyrë të dukshme ju ka ndihmuar të përmirësojnë njohuritë e tyre për të aplikuar në thirrjet e hapura për monitorim të zbatimit të strategjive lokale dhe planeve të veprimit në secilën komunë. Në këtë thirrje aplikacione kanë dorëzuar 15 organizata, prej tyre 10 organizata lokale kanë fituar grante (3 në Strumicë, 4 në Qendër dhe 3 në Strugë) dhe gjatë vitit kanë monitoruar procesin e zbatimit të katër strategjive lokale dhe planet e veprimit në tre komuna. Raportet e monitorimit për secilën strategji lokale në komunat do të publikohen dhe diskutohen me pushtetet lokale.



Në gjysmën e dytë të vitit 2016, me anë të marrëveshjes për bashkëpunim me *Fondacionin për Zhvillim të Komunitetit Lokal*, ishin zbatuar forume qytetare projektuese dhe buxhetore në secilën prej tre komunave. Gjatë tetorit janë zhvilluar forumet projektuese në të cilat kanë marrë pjesë 323 qytetarë (74 në Strugë, 114 në Qendër dhe 135 në Strumicë), gjatë së cilës ishin zgjedhur 4 projekte për ko-financim për të cilat ishin aprovuar dhe nënshkruar grant-marrëveshje me komunat, edhe atë: 1) rindërtim në infrastrukturë në fushën e mbrojtjes sociale – prokurimi i njësisë montuese të kontejnerëve për çerdhen e fëmijëve “Sonce” në komunën e Strugës; 2) ndryshim i pjesëve të drurit në JUDGOC “Korçagin”, objekti “Pinokio” në komunën Qendër; 3) vendosja e liftit për ushqim në JUDGOC “Koço Racin”, objekti “Naum Naumovski Borçe” në komunën Qendër; dhe 4) ndërtimi i OJQ qendrës së re për krijimin e mekanizmave për bashkëpunim institucional mes Komunës së Strumicës dhe sektorin qytetar në komunën Strumicë. Në gjysmën e parë të nëntorit dhe gjysmë së dytë të dhjetorit janë realizuar nga dy seanca të forumeve buxhetore në secilën prej komunave në të cilat kanë marrë pjesë 407 qytetarë (138 në Strugë, 83 në Qendër dhe 186 në Strumicë). Në këto seanca ishin diskutuar programet zhvillimore të komunave dhe ishin zgjedhur projekte prioritare për financim nga buxhetet komunale në vitin 2017.

Në kuadër të konceptit ishin zbatuar edhe aktivitete, me anë të kombinimit të disa veglave dhe qasjeve, që kanë kontribuar në plotësimin e qëllimit të dytë, dhe në drejtim të mundësimin të shërbimeve cilësore për qytetarët dhe përforcimit të shoqërisë qytetare për pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Në tre komunat, me anë të qendrave të komunitetit ishte mundësuar që 275 qytetarë të fitojnë ndihmë të drejtpërdrejtë administrative. Përveç kësaj, për qytetarët e komunës së Strumicës ishte përgatitur, publikuar dhe shpërndarë manual për kompetencat, procedurat dhe shërbimet e komunës, me qëllim të ndihmojnë qytetarëve që në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të tejkaluar paqartësitë në procedurat. Gjithashtu, ishte publikuar edhe broshura “Projekte të garantuar në komunën e Strumicës në vitin 2015” për të kontribuar për punën transparente të komunës dhe shpërndarje në mjeteve për shoqatat. Në komunën e Strugës ishte organizuar ditë informative në lidhje me publikimin e thirrjeve publike nga ana e komunës për financim të projekteve të organizatave qytetare dhe klubeve sportive, dhe gjithashtu ishte bërë edhe prezantim i rezultateve nga anketa e zbatuar për vlerësim të ndërmarrjeve komunale “Komunale” dhe “Proakva”. Në 11 trajnime, në tema të ndryshme, të zbatuar nga Qendrat e Komuniteteve, kanë marrë pjesë 223 pjesëmarrës të sektorit qytetar, por dhe nxënës dhe mësuesdhënës.

Një prej praktikave të mira, që kanë nxitur qendrat e komuniteteve në tre komunat, është realizimi i të a.q. ditë të hapura të komunës dhe anëtarët e këshillave komunal, me çfarë, në fakt, adresohen dy dimensione të punës së vetëqeverisjes lokale. E para ka të bëjë me vendosjen e komunikimit të drejtpërdrejtë të anëtarëve të këshillit komunal dhe të punësuarve në administratën komunale me qytetarët. Ditët e hapura janë zhvilluar në tema të ndryshme me interes të qytetarëve, dhe ishin zbatuar dhe organizuar nga të punësuarit e Qendrave të Komunitetit. Inovacioni ishte në faktin që këshilltarët kanë vepruar si anëtarët të komisioneve pranë këshillave komunal, dhe deri më tani, këtë lloj të komunikimit (në aspekt të

formatit dhe të temave) nuk ka qenë e organizuar nga komunat. Përfitimi është që diskutimi është zhvilluar në relacion këshilltarë – qytetarë, si formë e drejtpërdrejtë e llogaridhënies dhe transparencës. Dimensioni i dytë dhe përfitimi i kësaj praktike kanë të bëjnë me adresimin e një sfide sistemore i pranishëm në gjitha komunat e shtetit, dhe ajo është marginalizimi i rolit të komunës në krahasim me rolin dhe ndikimin e kryetarit të komunës. Sipas zbulimeve të vlerësimit të realizuar për zbatimin e konceptit të komunës sipas nevojës së qytetarëve, përfitimi nga ditët e hapura si praktikë përbëhet edhe në rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës së kryetarit ndaj këshillit, si dhe komuna ndaj qytetarëve. Gjatë vitit 2016 janë realizuar 10 ditë të hapura me përfaqësues të komisioneve pranë këshillave të komunave dhe të punësuarve në administratën në të cilën kanë marrë pjesë 275 qytetarë, në të cilën kanë pasur mundësi të diskutojnë për çështje dhe tema të interesit dhe nevojave të tyre.

Qendrat e Komunitetit në tre komunat janë përfshirë në procesin e hartimit të hartës sociale të komunës, që në mungesë të regjistrimit në nivel shtetëror, do të ndihmojë për planifikim më të strukturuar të aktiviteteve të komunës sipas nevojave të qytetarëve, si dhe të implikimeve financiare. Hartat sociale të komunave ishin shtypur në gjuhën maqedonishte dhe në shqipe, dhe ishin promovuar para më shumë se 160 qytetarë në tre komunat. Gjithashtu, në komunën e Strugës ishte përgatitur dhe shtypur një fletushkë për të drejta dhe obligimet e të rinjve, që ishte promovuar para më tepër se 500 nxënësve të shkollave të mesme të komunës. Ishin zbatuar edhe disa hulumtime të rëndësishme, si për shembull, për shërbimet në nivel lokal për nevojat e të rinjve (Qendër); për ingerencat dhe kompetencat e komunave në fushën e arsimit dhe kulturës (Strugë). Në komunën Qendër ishin realizuar dy anketa për prindër të fëmijëve të shkollave fillore për aktivitetet jashtë shkollore dhe për prindër të fëmijëve që shkojnë në çerdhe për aktivitetet që mendojnë se duhet të përfshihen në programet për punë me fëmijët. Qendrat e Komunitetit ishin në mënyrë aktive të përfshirë edhe në përgatitjet e propozim-versioneve të planeve të veprimtimit për kulturë në tre komunat.

Qendrat e Komunitetit ishin aktive edhe në mbështetjen e disa iniciativave qytetare, dhe zyrat e tyre ishin përdorur për mbështetje dhe organizim të ngjarjeve të organizatave lokale në të cilat kanë qenë të pranishëm 257 qytetarë. Gjatë fundit të vitit 2016, Qendrat e Komunitetit janë regjistruar në shoqata të qytetarëve dhe për ato janë siguruar grante për punë në 3 muajt e para të vitit 2017 me qëllim të mundësohet në atë periudhë të përfundimit të aktiviteteve për krijimin e buxhetit qytetar në çdo komunë por edhe në aplikim për fonde tek donatorë tjerë.

Projekti **Pjesëmarrje qytetare për demokraci lokale** ka filluar të zbatohet në janar 2016 me anë të grant programit të KE IPA 2 për mbështetje të shoqërisë qytetare dhe mediet për vitin 2014 dhe kanë zbatuar *FShHM* dhe *Qendra për Zhvillimin e Demokracisë Lokale* (QZhdL). Qëllimi i projektit është të ndihmojë organizatat qytetare që punojnë në fushën e kulturës në tre komunat partnere Strugë, Strumicë dhe Qendër në drejtim të pjesëmarrjes së tyre aktive në krijimin e politikave lokale të fushës së kulturës. Gjatë vitit 2016 ishte mundësuar një proces pjesëmarrës në të cilin ishin përgatitur dhe miratuar strategji për kulturë për

periudhën 2017-2022 në tre komunitat, të plotësuara me plane të veprimit. Në procesin e përgatitjes së strategjive për kulturë i kanë paraprirë një sërë trajnimesh dhe punëtori për përfaqësues të organizatave qytetare, institucioneve dhe të punësuar në administratën komunale dhe këshillat komunal. Programi për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhim strategjik dhe planifikim pjesëmarrës, që në çdo komunë ka përfshirë tre trajnime njëditëshe për veglat e planifikimit pjesëmarrës (51 pjesëmarrës), për planifikim strategjik dhe analiza të situatave (48 pjesëmarrës) dhe për metoda të planifikimit për veprim (34 pjesëmarrës), ju ka mundësuar pjesëmarrësve të njoftohen me procesin e planifikimit strategjik dhe veglave për planifikim pjesëmarrës; me llojet e analizave të situatave, përpilimit të analizave të situatave në fushën e kulturës, përcaktimi i misionit dhe vizionit për kulturë, qëllime strategjike, prioritet dhe masa, struktura e hartës së baraspeshuar të treguesve, qëllimet strategjike, prioritet dhe masa dhe planifikim për veprim. Si pjesë e programit për zhvillim të strategjisë me plan veprimit për kulturë ishin realizuar edhe trajnimet për analiza të situatave dhe vizione (47 pjesëmarrës); për zhvillim të kornizës strategjike (54 pjesëmarrës); dhe për zhvillim të planit të veprimit (61 pjesëmarrës).

Në kuadër të projektit ishte zbatuar dhe programi për përfundimin e kapacitetit institucional dhe organizativ dhe qëndrueshmërisë, që ishte synuar fillimisht për organizatat qytetare, por kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale. Ajo përbëhet nga katër trajnime njëditëshe në secilën prej komunave: Agjenda për kulturën 2020, konteksti nacional dhe ligjvënja përkundër politikës kulturore të BE-së (21 pjesëmarrës); inovacione dhe qasje shumë sektoriale në zbatimin e politikave lokale kulturore me përdorimin e praktikave më të mira dhe leksione të mësuara nga vendet tjera (17 pjesëmarrës); menaxhimi financiar, institucionet e BE dhe fondet për kulturë (25 pjesëmarrës) dhe menaxhimi me ciklin projektues (22 pjesëmarrës).

Përpjekjet e *FShHM* në kuadër të projektit **Qasje në drejtësi në Maqedoni**, me fokus të grupeve të marginalizuara dhe të varfër, financuar nga Bashkimi Evropian (Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut), ishte zbatuar me anë të mbështetjes së 5 organizatave qytetare për ndihmë falas juridike që kanë siguruar këshillime ligjore dhe ndihmë paraprake ligjore për 979 qytetarë. Prej 37 aplikacioneve për ndihmë falas juridike të dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë, 13 presim aprovim, për 10 raste është siguruar avokat në barë të shtetit, 1 rast është tërhequr dhe 13 ishin refuzuar. Për të përmirësuar përfaqësimin në 9 rastet para Gjykatës Administrative në lidhje me kërkesat e refuzuar për ndihmë falas juridike, projekti ka siguruar avokat dhe padi individuale. Një prej aktiviteteve kryesore të projektit është edukimi i qytetarëve për të drejta e tyre në dy fusha (të drejtat e punëtorëve dhe mbrojtja sociale), dhe në këtë drejti ishin zhvilluar 5 seanca për shkrim/lexim juridik për qytetarët që kanë marrë pjesë më shumë se 100 dhe të cilëve ju ishin shpërndarë manuale me informacionet më kryesore të këtyre dy fushave.

Në kuadër të projektit ishte përgatitur edhe dokument për politika publike dhe që përmban dobësitë dhe mungesat e Ligjit për Ndihmë Falas Juridike dhe

rekomandimet për përmirësime. Ky dokument ishte përgatitur në kërkesë të ekipit që zbaton projektin e binjakëzimit për përgatitjen e ligjit të ri për ndihmë falas juridike. Në fillim të projektit ishte zhvilluar edhe një softuer i veçantë që përdoret për regjistrim të gjithë kërkuessve të ndihmës falas juridike dhe mundëson përdorimin e të dhënave demografike të kërkuessve, problemet ligjore me të cilat përballohen, kohën që e ka të nevojshme Ministria e Drejtësisë për të marrë vendimin, si dhe kohën që është e nevojshme për Gjykatën Administrative për të marrë gjykimin.

## || INTEGRIMI I ROMËVE

### **Përforcimi i romëve për realizim të të drejtave shëndetësore**

Me qëllim që të avancohet statusi shëndetësor i romëve, *FShHM* zbatoi disa parime: 1) sigurim i mbrojtjes ligjore dhe ndihmës para-ligjore për sigurim të të drejtave shëndetësore; 2) llogaridhënie sociale për realizim të të drejtave shëndetësore që ndikojnë në statusin shëndetësor të shoqërisë rome, dhe 3) ndryshim i rrëfimeve negative ndaj romëve në institucionet shëndetësore.

Me përkrahje të *FShHM*, 8 organizata qytetare kanë siguruar ndihmë ligjore/para-ligjore për 1.917 raste në 10 shoqëri rome, (Shuto Orizari, Dellçevë, Vinicë, f. Crnik, Manastir, Prilep, Tetovë, Gostivar, Karposh dhe Gjorçe Petrov). Numri më i madh i problemeve janë të lidhur me mbrojtjen që drejtpërdrejtë ose jo-drejtpërdrejtë ndikon në realizimin e të drejtës për sigurim shëndetësor dhe të drejta tjera shëndetësore, ku më të përfaqësuarat janë të drejtat për refundim të shpenzimeve, marrja e kartelave shëndetësore, paraqitja e parregullsive tek Inspektorati shtetëror dhe sanitar dhe caktimi i terminëve për kontrolle specialistike. Përkrahje dhe përkrahjes të siguruar në raste individuale, janë zbatuar edhe iniciativa të përbashkëta tek më shumë organizata, si për shembull: kërkesa për ndryshime të dispozitave ligjore me të cilat të drejtat për ndihmë sociale ndërpriten në bazë të të ardhurave nëpërmjet transferimit të shpejtë të mjeteve;<sup>4</sup> përgatitja për raport në hije për çështjet e ndërlidhura me dispozicionin e shërbimeve gjinekologjike për romët, me pagesa e paligjshme dhe me diskriminimin e romeve, që u prezantua nga përfaqësues të organizatave qytetare dhe përfaqësues të bashkësisë rome në komisionin e 58 të Komitetit të OKB për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore në Gjenevë;<sup>5</sup> iniciativa tek Ministria e shëndetësisë për zgjedhjen e mungesës së shërbimeve gjinekologjike në komunën

<sup>4</sup> Dispozita kontestuese është larguar në janar 2016 me Rregulloren për Ndryshimin e Rregullores për mënyrën e përcaktimit të gjendjes së të ardhurave, pronave dhe të drejtat pronësore të amvisërisë, bartësit të së drejtës dhe dokumentimi i nevojshëm për realizimin dhe përdorimin e të drejtës për ndihmë sociale në të holla (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 13 të 27.1.2016).

<sup>5</sup> Si rezultat i përfaqësimit gjatë seancë së 58, KESKP ka dërguar rekomandime në RM: të intensifikojë përpjekjet për sigurim që shërbimet themelore shëndetësore janë të gatshme për të gjithë, pa dallim nga vendi gjeografik; shteti urgjentisht të ndalojë praktikën e pagesës së paligjshme; shteti anëtar të merr gjitha masat e nevojshme për rritjen e numrit të gjinekologëve dhe të sigurojë që gjithë gratë të kanë qasje në shërbime gjinekologjike në sajë të komunës, veçanërisht në Shuto Orizarë; si dhe të sigurojë metoda bashkëkohore të kontracesionit të jenë të gatshme për të gjithë.

Shuto Orizare;<sup>6</sup> si dhe dorëzimin e parashtrësive tek Avokati i Popullit nga gratë e bashkësive romë në Manastir dhe Prilep.

Organizatave partnere që sigurojnë ndihmë para-ligjore dhe mbështetje vazhdimisht punojnë në informim, edukim dhe njohje të popullatës lokale romë me të drejtat e tyre shëndetësore. Për këtë qëllim, ishin zhvilluar punëtori për: të drejtat e mbrojtjes së fëmijëve dhe shtojcës së veçantë për fëmijë; të drejta e pacientëve; realizimi i të drejtave nga mbrojtja shëndetësore para lindjes; mjetet për kontracëpsion; mundësitë për kontrolle falas dhe çështje tjera me interes për komunitetin rom. Përveç kësaj, për informim me kohë dhe më të mirë, në rrethinat romë rregullisht shpërndahen materiale të shtypura informative. Për tejkalimin e problemeve dhe pengesave që hasin romët gjatë realizimit të të drejtave shëndetësore, me rëndësi të veçantë janë lidhjet dhe komunikimet me institucionet kompetente shëndetësore. Me anë të takimeve të përfaqësuesve të komuniteteve romë me përfaqësues të institucioneve lokale shëndetësore, është mundësuar vetë-përfaqësim të komunitetit dhe kyçje të drejtpërdrejtë në diskutimet për problemet, por edhe për zgjidhje të mundshme për përmirësim të gjendjes, si dhe në kërkesën e përgjegjësive nga institucionet kompetente. Në këtë mënyrë, ndryshohen edhe qëndrimet dhe sjellja e punëtorëve shëndetësor ndaj romëve, dhe ato bëhet proaktiv në afrimin e komunitetit dhe dhënies së shërbimeve shëndetësore.<sup>7</sup>

Në vitin 2016, *FShHM* ka vazhduar mbështetjen për realizimin e aktiviteteve me të cilat organizatat partnere romë dhe përfaqësuesit e komuniteteve romë në vazhdimësi i ndjekin furnizimin dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore për imunizim, shëndetin e femrave, kontrolleve sistematike, vizitat nga shërbimet patronazhe, mbrojtjes pas lindjes, etj. Ishte zbatuar monitorim në komunitetin në lidhje me shërbimet dhe masat e përcaktuara në programet parandaluese shëndetësore për imunizim të fëmijëve rom (0-15 vjeç), kontrolle sistematike, skringing të hershëm për kancer të mirës dhe mbrojtjes para lindjes. Përfaqësuesit e organizatave qytetare dhe përfaqësuesit e komuniteteve romë kanë prezantuar zbulimet para institucioneve kompetente, por edhe para publikut më të gjerë. Në debatet publike dhe konferencat për shtyp ishin prezantuar mungesat e zbuluara dhe ishin parashtruar kërkesa të organizatave qytetare të drejtuar për institucionet përkatëse.

Me qëllim të sigurimit të veprimit përkatës për përforcimin e kapaciteteve të organizatave partnere, ishin zbatuar trajnime në temat vijuese: përmbajtje dhe buxheti i programeve parandaluese; mënyra e përgatitjes dhe miratimit të programeve parandaluese; cikli i buxhetimit lidhur me përgatitjen e programeve; zbatimi i përfaqësimit lidhur me ciklin e buxhetimit; dispozitat ligjore në lidhje me

<sup>6</sup> Rritje e subvencioneve shtetërore për gjinekolog që do të punojnë në Shuto Orizarë, dhe shteti të rezervojë 2 bursa për studentë të mjekësisë për gjinekologji që më tutje do të punojnë në këtë komunë.

<sup>7</sup> Me anë të reagimit të Parlamentit Qytetar Rom, Manastir, është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë, EPSH Spitali Klinik "dr. Trifun Pannovski" – Manastir, Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë – dega rajonale Manastir, Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë – sektori kontroll, zyra rajonale e Avokatit të Popullit të RM – Manastir, është nisur procedurë nga zëvendës avokati i popullit, me të cilën është ndaluar praktika e pagesës nga më herët gjatë kontrollit në spital, si dhe mungesa e letrave të lëshimit për pacientët që nuk janë në gjendje menjëherë të paguajnë pagesën pjesëmarrjes në spitalin klinik dr. Trifun Pannovski" – Manastir.

të drejtën e qasjes në informacione me karakter publik; zbatimi praktik i të drejtës për qasje në informacione me karakter publik; mbrojtja sociale dhe e fëmijëve; Ligji për Marrëdhënie Pune dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës; zbatimi i metodologjive të monitorimit të komunitetit dhe revizioni social; rrjetet sociale dhe rrëfimi i përrallave. Në drejtim të sigurimit të qëndrueshmërisë së intervenimeve për ndryshimin e rrëfimeve negative ndaj Romëve në institucionet shëndetësore, një grup i profesorëve nga katër fakultete të mjekësisë kanë përgatitur program mësimor për lëndën “Kompetenca kulturologjike dhe strukturore të profesionistëve shëndetësor” që do të jepet në studimet deri-diplomike në fakultetet e mjekësisë në Shkup, Manastir, Shtip dhe Tetovë.

### **Përforcimi i Romëve për përmirësim të rezultateve arsimore të tyre**

Përforcimi i Romëve për përmirësim të rezultateve të tyre arsimore është qëllim strategjik që ka zbatuar në vitin 2016 dhe *FShHM* ka punuar me anë të: 1) sigurimit të mbështetjes plotësuese jashtë-shkollore për nxënësit rom në arsimin fillor; 2) dhënia e bursave, ndihmë mentorimi dhe tjetër për studentët rom dhe 3) përfaqësimi i qëndrueshmërisë së rezultateve nga intervenimet e mëhershme arsimore të *FShHM*.

Me mbështetjen e *FShHM*, 436 nxënës rom të shkollave fillore nga Shkupi dhe Kumanova kanë fituar mbështetje të drejtpërdrejtë arsimore nga organizata qytetare romë *Dendo Vas* nga Shkupi dhe *Kham* nga Kumanova. Pjesa më e madhe e këtyre nxënësve ishin nxënës të kthyer, kërkues të azilit në shtetet evropiane, që pas kthimit në RM kanë qenë jashtë sistemit arsimor ose janë kyçur me vonësë. Ato ishin mbështetur në lidhje me dokumentimin dhe ri-regjistrimin për të kthyer në shkollë, më lehtë të zotërojnë materialin mësimor, të përgatiten për testimin ekstrën dhe me sukses të mbarojnë klasën.

Programi universitar komemorativ për bursa (RMSUP) dhe Programi për Bursa Mjekësore për Romët (RHSP) kanë kontribuar shumë për rritjen e numrit të regjistruar dhe të diplomuar të nxënësve në shkollat e mesme dhe të studentëve në vend. Për vitin akademik 2016/2017, janë dhënë 100 RMSUP bursa, prej tyre 84 studentë në ciklin e parë, 15 në të dytë dhe 1 për ciklin e tretë të studimeve. RHSP programi ka dhënë 20 bursa studentëve të mjekësisë; 16 prej tyre janë në cilin e parë, 2 në të dytin dhe 1 është në të tretin, ndërsa 1 student është në specializim. RHSP bursistët kanë marrë ndihmë mentori prej 12 profesorëve, të cilët bashkë me ata kanë marrë pjesë në kamp veror dhe trajnime për përfaqësim.

*FShHM* ka zbatuar trajnim në temën “Çfarë është arsimit cilësor inkluziv dhe si të arrijmë në atë?” për përfaqësues të 5 organizatave qytetare që punojnë për çështje të ndryshme lidhur me përfshirjen e fëmijëve rom në arsim. Trajnimi ka pasur për qëllim të njoftojë nxënësit me aspektet, parakushtet, indikatorët dhe me masat e avancimit të arsimit inkluziv në nivel të komunitetit dhe shkollës. Në kohën e njëjtë, në trajnim janë diskutuar edhe format e segregacionit në arsim, si dhe përfitimet nga arsimit cilësor inkluziv. Qëllimi i trajnimit “Arsimit pozitiv” që *FShHM* ka zbatuar për mësimdhënësit e katër shkollave fillore, ishte njohja me përfitimet e arsimit pozitiv dhe efektet për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Trajnimi ka

përpunuar faktorë e mirëqenies psikologjike, stilet kognitive të mësimit dhe lidhjet me suksesin në shkollë dhe mirëqenien psikologjike të nxënësve, si dhe veçoritë e një shkolle të mirë.

Për të përgjigjur nevojave urgjente të anëtarëve të 31 familjeve rome që kanë mbetur pa shtëpi pas rrënimit të vendbanimeve të improvizuar nën Kale (në mesin e tyre edhe persona pa dokumente, gra shtatzënë, persona të sëmurë dhe fëmijë të vegjël), me anë të *Iniciativës për zhvillim dhe inkluzion të komuniteteve (IZHIK)* ju ishin dhënë ushqim, pelena për fëmijë dhe mjete themelore për jetë.

## || NDIHMË HUMANITARE DHE JURIDIKE PËR MIGRANTËT

Gjatë vitit 2016 ishin shpërndarë 100.000 paketime me ushqim dhe ju është dhënë ndihmë më tepër se 700.000 personave gjatë transitimit nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë. Ishin dokumentuar më tepër se 30 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të folurit e urrejtjes. Analizat e politikave dhe praktikave kanë zbuluar mundësi për avancimin e politikave. Ishin organizuar debate publike dhe ngjarje promovuese interaktive me qëllim të informimit të publikut për aspektet humanitare të krizës me refugjatë dhe migrantë dhe të potencohen shkeljet e të drejtave të njeriut dhe standardeve ndërkombëtare. Përfaqësues të organizatave partnere i kanë prezantuar zbulimet nga monitorimi i zbatuar, si dhe rekomandimet e tyre, në ngjarje të shumta kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për përfaqësim. Mediet sociale ishin përdorur për promovim të aktiviteteve dhe për dërgim të mesazheve të urgjencës për mbrojtje përkatëse të personave në lëvizje. “Fjalorthi Migrator për Medie” ishte përkthyer në gjuhën maqedonishte dhe shqipe me qëllim të ndihmohet përparimi i shkathtësive të medieve profesionale. Fushata publike kundër ksenofobisë “Fëmijët e planetit Tokë” ka potencuar lidhjet dhe dallimet mes grupeve të ndryshme shoqërore, ka shqyrtuar mendimin publik negativ dhe ka thirrur publikun të mendojë sërish për sjelljen dhe qëndrimet.

*Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shoqata Maqedonase për Juristët e Rinj dhe Organizata për ndihmë humanitare LEGIS janë bashkëngjitur FShHM në zbatimin e këtij koncepti nga gushti 2015 deri në janar 2017.*

## || KORNIZA E PËRBASHKËT PËR PËRFORCIM LIGJOR

Në vitin 2016, *FShHM* ka filluar me zbatimin e iniciativës katërvjeçare që kanë për qëllime kryesore krijim të kornizës së përbashkët për përforsim ligjor dhe institucionalizimi i saj me anë të rritjes së formave të ndryshme aktuale të sigurimit të qasjes në drejtësi që bazohen në komunitet për nevojat e Romëve, punëtorëve seksual, përdoruesit e drogave dhe grupeve tjera të marginalizuar, në nivel lokal dhe kombëtar. Deri në fund të vitit 2020 pritet që të themelohet partneritet mes përfaqësuesve të institucioneve relevante shtetërore, pushtetin lokal dhe organizatat qytetare, siguruesit e ndihmës ligjore dhe para-ligjore, me qëllim që bashkërisht të punojnë në përparimin e financimit të formave të ndryshme të sigurimit të ndihmës ligjore/para-ligjore. Iniciativa është pjesë e përpjekjeve globale të *fondacioneve Shoqëri e Hapur* për institucionalizim të shërbimeve themelore ligjore në nivel kombëtar, dhe në atë, përveç Maqedonisë, marrin pjesë edhe 9 vende tjera (Moldavia, Mongolia, Nepal, Pakistan, Siera Leone, Afrika Jugore, Ukraina, SHBA dhe Indonezia).

Gjatë vitit 2016, *FShHM* ishte drejtuar në: 1) Rritje të numrit të përdoruesve të ndihmës ligjore/para-ligjore (të varfër, Rom, punëtorë seksual dhe përfaqësues të grupeve tjera të marginalizuar) dhe rritje të drejtave për shkrim/lexim; 2) zgjerimi i formave për sigurim të ndihmës ligjore me anë të zhvillimit të klinikës ligjore universitare; dhe 3) zbatimi i analizave dhe hulumtimeve dhe krijimit të partneriteteve për përfaqësim të përbashkët me organizatat qytetare që synojnë përforsimin ligjor.

Për realizim të qëllimi të parë, janë përpiluar aktivitete që zbatohen nga 8 organizata qytetare, të cilët sigurojnë ndihmë ligjore dhe para-ligjore dhe 5 organizata qytetare që sigurojnë ndihmë falas juridike.

Në sajë të kësaj iniciative, është zhvilluar edhe koncepti i klinikës ligjore për grupet e cenuar në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup. Klinika ligjore do të përforsojë shkathtësitë praktike të studentëve dhe të kuadrit mësimor për punë me grupe të cenuar (persona social të rrezikuar, LGBT, punëtorë seksual dhe Romë), në drejtim të zgjidhjes së problemeve të tyre dhe do të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve institucionale për avancimin e mekanizmave për mbështetje ligjore. Fakulteti Juridik do të mundësojë forma të reja të zbatimit të mësimi praktik ndër-disiplinor për studentë në bashkëpunim me organizatat qytetare, themelimi i edukimit klinik për studentët, si dhe sigurim i informacioneve për të drejtat dhe mënyrën e realizimit të tyre në komunitet.

<sup>8</sup> H.E.R.A. – Asociacioni për Arsim Shëndetësor dhe Hulumtim; Asociacioni për Zhvillim Demokratik të Romëve “SONCE”; Roma SOS – Organizata rome për afirmim shumë kulturor; Shoqata e qytetarëve për mbështetje shëndetësore, sociale dhe arsimore “Iniciativa për zhvillim dhe inkluzion të komuniteteve” Shkup; CDRIM – Qendra për Zhvillim Demokratik dhe Iniciativa; OJQ KHAM Delçevë; Shoqata e punëtorëve të arsimit dhe mbrojtja e të drejtave të grave dhe fëmijëve – LIL Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut të RM-së

<sup>9</sup> Këto aktivitete janë përshkruar në kuadër të konceptit Komuna sipas Qytetarëve dhe konceptit Integrimi i Romëve.



Për të siguruar përfaqësim të argumentuar për realizim të qëllimit kryesor të iniciativës – institucionalizim i formave të ndihmës ligjore/para-ligjore – gjatë vitit 2016 janë zbatuar: analizë të shpenzimeve dhe përfitimet nga sigurimi i llojeve të ndryshme të ndihmës ligjore dhe para-ligjore falas në komunitet; hulumtim për fuqinë e drejtë dhe qasjen në drejtësi për personat që përdorin droga dhe për punëtorët seksual; hulumtim të perceptimit publik dhe njohja e qytetarëve me Ligjin për Ndhinë Juridike Falas; ndërsa në zbatim është edhe hulumtimi për nevojat ligjore të popullatës rome në Maqedoni.

Në vitin e parë të zbatimit të iniciativës për përforsim ligjor, me qëllim të përforsimit të përfaqësimit, është formuar një rrjet prej 19 organizatave siguroes të ndihmës ligjore dhe para-ligjore falas. Janë zhvilluar 4 takime në të cilat janë shpërndarë përvojat nga puna, ishin prezantuar përvojat e pjesëmarrësve në kursin ndërkombëtar për përforsim ligjor dhe zbulimet fillestare të hulumtimeve, dhe në punëtorinë e fundit treditore ishte zbatuar një planifikim i përbashkët strategjik.